



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 226, Datë 27.12.2016

PËR

**MIRATIMIN E SHOQËRISË AUDITUESE, PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE
FINANCIARE TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE, PËR VITIN
2016**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 16, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, me vendimin nr. 196, datë 24.11.2016, miratoi kriteret e përzgjedhjes së ekspertit kontabël të regjistruar ose shoqërisë audituese, për auditimin e pasqyrave financiare të AMF-së, për vitin 2016.

Në zbatim të këtij vendimi, si dhe me qëllim mundësimin e marrjes së shërbimit “Për auditimin e pasqyrave financiare të AMF-së, për vitin 2016”, Sektori i Shërbimeve dhe Prokurimeve, procedoi me zbatimin e procedurave të prokurimit publik sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

Bazuar në nenin 29 pika 5 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me datë 06.12.2016 u procedua me zhvillimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël me fond limit 500,000 lekë me tvsh ose 416,667 pa tvsh, me objekt “Auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 të AMF-së”.

Në përfundim të përzgjedhjes në sistemin elektronik të APP, rezultoi fitues për ofrimin e shërbimit të kërkuar shoqëria audituese “Grant Thornton”. Pas verifikimit të dokumentacionit të depozituar, rezulton se kjo shoqëri ka përmbushur kriteret e miratuara nga Bordi i AMF-së.

Përsa më sipër, Bordi i Autoritetit,

V E N D O S I :

- 1. Miratimin e shoqërisë audituese “Grant Thornton” sh.p.k., për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2016, të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme/ Sektori i Prokurimeve dhe Shërbimeve, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Enkeleda SHEHI